



PROJEKTI TEKNIK PËR LEJE NDËRTIMI:

**STRUKTURË EKOLOGJIKE, E GJELBËR, ME KONSTRUKSION DRUROR, NË
OBORRIN E BRENDSHËM TË KRYEMINISTRISË**



**RAPORT TEKNIK
I INTEGRUAR**

Grupi i Punës

Projekti Arkitektonik:

Ark. Adelina Greca – Nr. Lic. A1110/1

Ark. Matilda Hazizaj – Nr. Lic. A1533/1

Ark. Arjon Kadillari

Ark. Greta Parroj

Projekti Konstruktiv:

Ing. Arben Dervishi – Nr. Lic. K0215/6

Projekti Elektrik:

Ing. Dëshira Mena – Nr. Lic. E00610/3

ING. DESHIRA MENA
NR. LIC. E0610/3

Projekti Mekanik:

Ing. Aleksandër Konomi – Nr. Lic. M0218/1

Ing. Arkida Zeko – Nr. Lic. M1293



PROJEKTI TEKNIK PËR LEJE NDËRTIMI:

**STRUKTURË EKOLOGJIKE, E GJELBËR, ME KONSTRUKSION DRURI, NË
OBORRIN E BRENDSHËM TË KRYEMINISTRISË**

RAPORTI ARKITEKTONIK

Grupi i Punës

Projekti Arkitektonik:

Ark. Adelina Greca - Nr. Lic. A1110/1

Ark. Matilda Hazizaj - Nr. Lic. A1533/1

Ark. Arjon Kadillari

Ark. Greta Parroj

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

RAPORTI ARKITEKTONIK

Kompozimi i Strukturës ekologjike, të gjelbër, me konstruksion druri



Përmbatja:

- 1- Vizioni
- 2- Koncepti
- 3- Identiteti
- 4- Planvendosje
- 5- Përdorimi – Programi (fleksibilitet)
- 6- Ekologjia
- 7- Struktura, materialet
- 8- Skema e mbrojtjes nga zjarri
- 9- Sistemi i furnizimit dhe komandimit të vaditësve
- 10-Skemat e furnizimi me ujë / instalimet elektrike

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. Z0610/3

1. Vizioni

Projekti është një zgjidhje ekologjike, e gjelbër, si përgjigje e sfidave të shekullit tonë për impaktin që duhet të kenë strukturat e ngritura nga njeriu në mjedis. Struktura në fjalë është e qendrueshme dhe 'e gjallë', e cila do të kthejë hapësirën ku do të instalohet nga një hapësirë 'e mbetur midis' në një oborr që krijon vend. Ajo është një strukturë thujtase e hapur dhe e depërtueshme, e sigurt dhe **e destinuar për takime protokollare dhe evente publike të një rendësie të veçantë**. Kjo strukturë synon të prezantoj një vepër të realizuar nga njeriu, por me një përkujdesje të posaçme ndaj natyrës, si edhe një reprezentim të natyres së munguar shpeshherë në mjediset tona të ndërtuara.

Duke parë në kushtet e tanishme të ndërtesës Kryeministria 1, shikojmë që pothuajse të gjitha grilat e dritareve përreth janë të ulura. Qëllimi i këtij projekti është gjithashtu të krijojë një objekt qendror, për të cilin do t'ia vlejë që grilat përreth të hapen dhe pamja, aromat dhe oksigjeni që çliron bimësia e dendur të depërtojnë edhe në zyrat e punës, së këtij institucioni të rendësishëm. Është provuar shkencërisht efekti pozitiv që krijon afërsia me natyrën në mjediset e punës dhe qëllimi është që ky projekt të ketë efekte anësore pozitive edhe për administratën.

Kur shikojmë natyrën, ajo ka një ndikim të thellë në gjendjen tonë gjatë të punuarit. Me këtë projekt krijojmë një vepër që ndryshon paraqitjen dhe ngjyrat e saj sipas sezoneve.

2. Koncepti

Koncepti i Strukturës është përgjigje e situatës që krijohet në oborr. Në vend që të vendoset një kopësht në nivelin e tokës (sipërfaqe), krijojmë një kopësht 3-dimensional që siguron funksione përdorimi zyrtar, protokollar, si edhe rekreacioni, 'gjallërimi' në nivele të ndryshme.


3. Identiteti

Një ikonë e teknologjisë

**Detajimi i Projekt-Idesë*

Projekti teknik për leje ndërtimi i Strukturës ekologjike, të gjelbër, me konstrukcion druri, është detajuar mbi bazën e koncept-idesë së vendosur në dispozicion nga Kryeministria (konceptuar nga "Precht")

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013



Nga një ikonë e teknologjisë në një ikonë të ekologjisë.

[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]




Si të transformojmë oborrin e Kryeministrit në një ikonë të rafinuar të rritjes, shëndetit dhe gjallërisë?



Si të krijojmë një hapësirë publike dhe një skenë për evente



Si të projektojmë një hapësirë të aksesueshme dhe të përshkrueshme për të gjithë banorët e Tiranës.



Si të parashikojmë një konstatim ekologjik që promovon një mënyrë jetese të shëndetshme dhe të qëndrueshme?

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. 20610/3

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]




[Handwritten signature]

[Handwritten signature]





ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3



ING. DESHIRAMEN
NR. LIC. Z061013

Jur

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]



[Signature]







ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

Gaz




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3



  
11




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. 2061013

ka
Gurb
mishu

4. Planvendosje



Bulevardi Dëshmorët e Kombit

Rruga Ismail Qemali

1:1000

[Handwritten signature]

ING. DESHIRA MENA
NR. LIC. E 0610/3


[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



1:2000

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]
[Handwritten signature]
[Handwritten signature]



5. Përdorimi - Programi (fleksibilitet)

Dizajni i ndjekur në hapësirën e depërtueshme të Strukturës lejon zhvillimin e programeve dhe eventeve publike të ndryshme. Shkallët përfshijnë elementë ulës që janë të lëvizshëm sipas kërkesës, fleksibël dhe të vendosur sipas nevojës, në raste të ndryshme.



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

15

Tribuna dhe shkallët




Tribuna, një rampë me ulëse, ofron një platformë për evente gjatë ditës (konferenca zyrtare) dhe në mbrëmje (leksione, koncerte, fjalime), ndërkohë që bimët në strukturë mbështjellin audiencën me një kuvertë natyrale dhe do të ofrojë një sfond jo vetëm të bukur për eventet, por edhe miqësor për pjesëmarrësit.







ING. DESHIRA MENA
NR. LIC. E0610/3









KATI 0




KATI 1




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013





17





KATI 2




KATI 3

ING. DESSA MAMENA
NR. LIC. E061013





AKSONOMETRI



ZYRA DHE SALLA E TAKIMEVE





ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3


19




[Handwritten signature]
[Handwritten signature]

[Handwritten signature]
ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3
[Handwritten signature]

[Handwritten signature] *[Handwritten signature]* *[Handwritten signature]* *[Handwritten signature]*




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 061013

Hapësirat e mbyllura

Janë katër hapësira të mbyllura përgjatë strukturës. Ato sigurojnë hapësirë për shtypin, takime private, leksione dhe një mjedis të vogël shërbimi. Dyert mund të mbyllin hapësirat për takime private ose të hapen plotësisht për tu lidhur me natyrën.

Tavani prej (xhami) materiali translucjent/parent dhe jep një pamje shumë të mirë nga bimët natyrore që varen në 'pergola'. Gjithashtu këto bimë kacavjerrëse sigurojnë një hijezim natyral për hapësirat.



ING. DESHIRAMERHA
NR. LIC. 2061010


Kalimet

Qarkullimi zhvillohet përgjatë dhe përbrenda gjelbërimit. Ndenjëset e vogla lejojnë përdoruesit t'i përdorin për programe të ndryshme (biseda pune, pushim, etj). Këto janë mjedise të vogla, por shumë cilësore dhe pozitive, për t'u mbushur me oksigjen dhe të zhvilluar takime të ndryshme.



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

6. Ekologjia



Cikli i ujit, grumbullimi aktiv diellor, materialet me emetim të ulët të karbonit, qasja e orientuar nga komuniteti, në përputhje me parimet e UNSDG




ING. DESHIRA MENA
NR. LIC. E 061013

Peizazhi dhe Mbjellja

Struktura ekologjike, e gjelbër është zhvilluar për të siguruar një qarkullim ekologjik. Në tarracën ekzistuese të ndërtesës së Kryeministrit do të instalohen panele diellore që do sigurojnë energji për Oborrin.

Një pellg uji në katin përdhës ofron një rrjedhë të qëndrueshme për ujitjen e bimëve në strukturë. Lëvizja e ujit gjithashtu siguron ajër të freskët për ndërtesat përreth.



[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

25
[Handwritten signature]

Gjelbërimi ka për qëllim të mbështesë aktivitetet zyrtare-protokollare, rekreacionin, 'gjallërimin' dhe kohën e lirë në kopshtin 3-dimENSIONAL.






gjithpërfshirëse





natyrale



një me
arkitekturën




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. Z0610/3


27






bimë dritëdashëse




bimë gjysmë hijedashëse


bimë hijedashëse



Pemë gjetherënëse për të lejuar dritën të depërtojë në strukturë gjatë dimrit.



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013




pranverë - verë



vjeshtë




dimër

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3



KATI PËRDHE
bimësia e zgjedhur



[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. Z0610/3

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]


[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



KATI I PARË
bimësi e zgjedhur



■ hapësirë çlodhëse
■ auditorium

lista e bimëve hijdashese




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

Jan 22



KATI I DYTË
bimësia e zgjedhur



lista e bimëve gjysmë hijedashëse



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3



KATI I TRETË
bimësia e zgjedhur



hapësirë çlochëse

lista e bimëve dritëdashëse



[Handwritten signature]



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013



[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013





Pamje e përgjithshme e strukturës

Pamja nga Veri- Lindja

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

39




Pamje e përgjithshme e strukturës



Pamja nga Jug - Perëndimi



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013










Pamje e përgjithshme e strukturës
Pamja nga Jug- Lindja



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3



41



Pamje e përgjithshme e strukturës

Pamja nga Veri- Perëndimi


ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3




Jm

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. 2061013

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]

[Signature]




7. Struktura, materialet

Struktura ekologjike, e gjelbër qëndron në një rrjetë 4800x4800x4800mm. Trarët prej druri të ndërthurur kryq përbëjnë një kornizë modulare kubike 6x3x4, që shërben si strukturë. Konstruksioni i drurit të parafabrikuar do të garantojë zbatim të saktë, bashkim të shpejtë në vendndodhje dhe emetim në vlera të ulëta të karbonit, në krahasim me materialet konstruktive tradicionale, siç janë betoni dhe çeliku.

Projekti ngrihet në një rrjet 3-dimensional, me bimësi dhe pemë (preferohen pemë të rritura, lokale ose të rritura jashtë). Rrënjët e pemëve kanë nevojë për hapësirë. Vazot sferike prej bakri lejojnë pemët të rriten dhe të transmetojnë një reflektim interesant të strukturës dhe hapësirës përtej.

Tubat janë kryesisht të ekspozuar; një projektim i sinqertë që nxjerr në pah funksionin dhe rëndësinë e ujit për bimët dhe jetën.



Skica të detajeve konstruktive

[Handwritten signature]

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

[Handwritten signature]



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

Jm

[Signature]

[Signature]


[Signature]

[Signature]

[Signature]


[Signature]

8. Skema e mbrojtjes nga zjarri




ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. 2061013

9. Skemat e furnizimi me ujë / instalimet elektrike




Kati Përdhes




Kati 01

- tub vertikal i furnizimit me ujë / elektricitet
- spërkatës uji tokësor
- tub horizontal i furnizimit me ujë / elektricitet

ING. DESHIRASE
NR. LIC. 20061313



Kati 02



Kati 03

- tub vertikal i furnizimit me ujë / elektricitet
- spërkatës uji tokësor
- tub horizontal i furnizimit me ujë / elektricitet

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013



PROJEKTI TEKNIK PËR LEJE NDËRTIMI:

**STRUKTURË EKOLOGJIKE, E GJELBËR, ME KONSTRUKSION DRURI, NË
OBORRIN E BRENDSHËM TË KRYEMINISTRISË**

RAPORT ELEKTRIK

Grupi i Punës

Projekti Elektrik:

Ing. Dëshira Mena – Nr. Lic. E00610/3

ING. DESHIRA MENA
NR. LIC. E00610/3

RAPORTI ELEKTRIK

Instalimet elektrike te Strukturës ekologjike, të gjelbër, me konstrukcion druri



Përmbatja:

A. Shpërndarja në tension të ulët

11-Rrjeti i shpërndarjes së fuqisë

12-Rrjeti i shpërndarjes së ndriçimit

13-Rrjeti i shpërndarjes së sinjaleve

14-Rrjeti i shpërndarjes së ndriçimit emergjent

15-Rrjeti i detektimit të zjarrit

16-Rrjeti i lajmërimit zanor

17-Rrjeti i vëzhgimit me kamera

18-Sistemi i furnizimit dhe komandimit të vaditësve

19-Sistemi i kontrollit të aksesit

20-Sistem audio-konferencë

21-Rrjet i furnizimit me panele fotovoltaik

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013



A. Shpërndarja në tension të ulët

Shpërndarja në tension të ulët fillon nga paneli kryesor ekzistues i objektit. Me pas nga ky panel shpërndarje furnizohen impiantet e ndryshme elektrike. Linjat elektrike në këtë ambient do të ndryshojnë në përbërje, sipas rastit të instalimit, duke përdorur një kanalinë që do të montohet nën trarë për një shpërndarje kryesore dhe më pas linjat do të jenë në tuba metalikë të montuar në sipërfaqe të trarëve të ndryshëm deri në instalimet që do të furnizohen. Kalimi kryesor i linjave nga një nivel në tjetrin do të realizohet nëpërmjet 'shafteve' vertikale, të cilat janë të kamufluara me vegjetacion (lianas).



Sistemet që gjenden në këtë strukturë janë:

- 1- Rrjeti i shpërndarjes së fuqisë
- 2- Rrjeti i furnizimit të ndriçimit
- 3- Rrjeti i shpërndarjes së të dhënave
- 4- Rrjeti i ndriçimit emergjent
- 5- Rrjeti i detektimit të zjarrit
- 6- Rrjeti i lajmërimit zanor
- 7- Rrjeti i vëzhgimit me kamera
- 8- Sistemi i furnizimit dhe komandimit të vaditësve
- 9- Sistemi i kontrollit të aksesit
- 10- Sistem audio-konferencë
- 11- Rrjet i furnizimit me panele fotovoltaike

1- Rrjeti i shpërndarjes së fuqisë

Rrjeti i shpërndarjes së fuqisë konsiston në furnizimin me energji elektrike të të gjitha prizave dhe daljeve të fuqisë, me anë të tubave metalikë të montuar në sipërfaqe ose kanalinë. Linjat e prizave dhe ndriçimit mbrohen me automatë termomagnetik një-polar, të montuar në kuadrin elektrik.

Ky objekt është i përbërë nga një strukturë druri me 4 kate mbi tokë dhe shpërndarja vjen nga linja nga objekti ekzistues që pastaj shkojnë tek kati 2 i strukturës dhe shpërndahen në katet e tjera me një kanalinë të montuar vertikalisht.

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

51



Prizat ndodhen në zonat e mbyllura me xham dhe janë vendosur, sipas rastit, ose të montuara mbi sipërfaqen e trareve, ose në kuti elektrike në dysheme. Daljet e fuqisë për antenat Wi-Fi do të montohen në trarë, po brenda këtyre hapësirave, por në afërsi të tavanit të këtyre dhomave. Prizat do të përdorin përcjellës me seksion 2.5mm², kurse antenat 1.5mm².

Kjo strukture ekologjike, e gjelbër, me konstruksion druri, gjithashtu do të duhet të ketë një sistem furnizimi të enërgjisë rezervë dhe kritike në formën e lidhjes me një UPS dhe gjenerator. Struktura do të ketë gjeneratorin dhe UPS e saj të veçantë që do të vendoset brenda hapësirave të oborrit (ose në një mjedis aty afër, ku të vlerësohet e përshtatshme gjatë detajimit të projektit të zbatimit).



2- Rrjeti i shpërndarjes së ndriçimit

Rrjeti i shpërndarjes së ndriçimit konsiston në ndriçimin e ambjenteve dhe komandimin e këtyre pikave të ndriçimit në pozicionet që duhet. Në strukturë, komandimi bëhet në hyrje të ambjenteve nga sensorë prezence të montuar në trarë. Kurse për pjesen tjetër të ndriçimit është menduar të bëhet një komandim i centralizuar me KNX që lejon për krijim skenarësh dhe ndryshim ndriçimi sipas orarit dhe/ose nivelit të ndriçimit natyral. Linjat e ndriçimit në objekt realizohen me përcjellës të tipit NO7V-K në seksion 3x (1x1.5)mm², të futur në tuba metalik. Sistemi KNX do të jetë i kompletuar dhe tërësisht i pavarur, dhe do të përfshijë të gjithë pajisjet e kabllimet të nevojshme për një sistem të plotë funksional. Kjo do të thotë se switch, aktuatorë, kontaktorë, 'gateway' dhe ushqyes do të duhet të furnizohen për strukturën së bashku me kabllimet e ndryshme AUX, BUS dhe linja fuqie.

Ndricuesit e planifikuar të përdoren janë:

- 1) Ndriçuesi inkaso për vazot, me mbrojtje minimalisht IP65;
- 2) Ndriçuesi LED shirit modular që do të përdoren për ndriçimin e ambjenteve të mbyllura, shkallëve dhe disa pjesëve kyçe të vegjetacionit;
- 3) Shaftet e vegjetacionit do të kenë ndriçues mural të montuar në sipërfaqe të kolonave të drurit, për t'i vënë në dukje;
- 4) Kolonat e drurit, në pjesën e jashtme të strukturës (mes strukturës së re dhe objektit ekzistues) do të kenë ndriçuesi projektor LED;
- 5) Shkallët do të kenë një ndriçues tokësor të mbuluar, për të ndriçuar hapat e shkallëve;

ING. DESHIRAMEN
NR. LIC. 2061012

- 6) Ndrichues mural që do të instalohet nëpër kolona, për ndriçimin në brendësi të strukturës;
- 7) Ndrichuesa të varur specifikisht për hapësirat e mbyllura të objektit.



3- Rrjeti i shpërndarjes së sinjaleve

Rrjeti i shpërndarjes së sinjaleve konsiston në shpërndarjen e prizave të IT-së në vendet e caktuara nga plani. Në projekt janë parashikuar dalje-data për çdo ambient të mbyllur. Gjithashtu është parashikuar shtrirja e një tubi metalik për këto linja. Këto do të lidhen me sistemin e godines ekzistuese që të integrohen si pjesë e objektit.



4- Rrjeti i shpërndarjes së ndriçimit emergjent

Ndrichuesat e emergjencës janë vendosur në hyrjet e strukturës nga ndërtesës ekzistuese në katin përdhe dhe katin 2. Lidhja e tyre është e ngjashme me ndriçimin normal me ndryshimin që nuk kontrollohen nga sensorë ose sistemi i centralizuar, por me rele në kuadër, dhe se përdorin një kablë FR-OR me seksion 3x1.5mm² i futur në tub fleksibël të rëndë Ø16mm, meqë të gjitha janë të instaluar tek fasada të ndërtesës ekzistuese. Hyjnë në punë në mënyrë automatike në raste humbje energjie në kuadër dhe sigurojnë ndriçim për të gjithë ambientin për rreth 2 orë.

5- Rrjeti i detektimit të zjarrit

Ky sistem do të jetë më së shumti i përbërë nga sensorë tymi të vendosur mbi sipërfaqen e trarëve në ambientet e mbyllura që t'i përshtatet kushteve të sigurisë. Këto detektorë do të lidhen me sistemin ekzistues anti-zjarr. Këto sensorë do të jenë të gjithë pjesë e një loop-i pasi numri i tyre dhe gjatësia e linjës është tejet i vogël për të justifikuar ndarjen e tyre në loop të ndryshëm. Kablli i përdorur do të jetë një kabël me seksion 2x1mm² me skermë që do të kalojë në kanalinen e paarashikuar dhe sensorët do të montohen në trarët në tavan të katit ku janë.

6- Rrjeti i lajmërimit zanor

Duke marrë parasysh që struktura është i izoluar nga pjesa ekzistuese e ndërtesës dhe sistemet e saj të sigurisë, është e rëndësishme të parashikohet

ING. DESHIRAMER
NR. LIC. E 061015

53



një sistem lajmërimi zanor për të rritur sigurinë e shfrytëzimit të këtyre ambjenteve dhe të komunikojnë me ambjentet e brendshme të godinës në raste emergjence. Ky sistem do të jetë më së shumti i përbërë nga bokse me instalim mural të vendosur mbi sipërfaqen e trarëve në ambjentet e mbyllura dhe për çdo kat të hapur, që t'i pershtatet kushteve të sigurisë. Gjithashtu në nivelin përdhe do të vendosen bokse në cepat e oborrit që të arrihet një shpërndarje e plotë e zërit.

Do të bëhet intergrimi me sistemet ekzistuese të emergjencës. Të gjitha bokset do të lidhen me një linjë me kabëll 2x0.8mm² për foni që do të shpërndahet me së shumti nëpërmjet kanalines së parashikuar.

Ky sistem do të jetë i aftë të krijojë mesazhe të regjistruara ose lajmërimi për raste të ndryshme emergjence që kërkojnë vëmendjen e përdoruesve të strukturës dhe/ose evakuimin e tyre.



7- Rrjeti i vëzhgimit me kamera

Duke ditur rendësinë e objektit ku do të ndërtohet struktura ekologjike - e gjelbër, duhet pasur kujdes i veçantë në krijimin e një sistemi monitorimi për të. Pra do të instalohen kamera që të bëjnë monitorimin 24 orë/7 ditë në javë të strukturës, me kualitet të lartë. Kamerat do të monitorojnë pikat e hyrjes në strukturës në katin përdhe dhe katin 2, me kamera për ambjente të jashtme që do të kenë mbrojtje anti-vandal dhe ndaj kushteve të ndryshme atmosferike. Gjithashtu do të monitorohen edhe ambjentet e mbyllura me kamera për ambjente të brendshme, me kualitet të lartë video, që të arrihet një nivel sigurie i përshatshëm.

Ky sistem do të integrohet me sistemin ekzistues të sigurisë dhe do të monitorohet që të jetë pjesë e sigurisë së gjithë objektit ekzistues.

8- Sistemi i furnizimit dhe komandimit të vaditësve

Meqënëse struktura ekologjike - e gjelbër, do të jetë e përberë në pjesën më të madhe të saj nga vegjetacioni, do të duhet një sistem vaditje **automatizuar** që ta mbajë gjallë florën sipas kërkesave specifike të çdo bime. Si fillim do të duhet furnizim për pompën me kablo elektrik, seksioni i të cilëve do të vendoset sipas fuqisë së këtyre pajisjeve, që do të jetë midis 5x4mm² për furnizimin e pompave. Gjithashtu do të instalohet një sistem i centralizuar komandimi që do të kryejë aktivizimin e vaditësve, sipas kërkesave të bimësisë që kanë nën kontroll dhe kushteve atmosferike, dhe që do të kryejë ruajtjen e

ING. DESHIRANE

NR. LIC. 20061013

eventeve dhe lajmerime në raste avarish. Ky sistem komandimi do të modelohet si BMS.



9- Sistemi i kontrollit të aksesit dhe alarmit

Do të parashikohet një impiant i kontrollit të aksesit dhe alarmit, sipas vizatimeve.

Për çdo akses në këto ambiente do të parashikohet një lexues karte, i cili montohet afër derës, dhe për daljen do të instalohet një buton komandimi për çbllokimin e bravës magnetike të derës nga lexuesi i kartës respektive. Sistemi do të komunikojë me centralin qendror ekzistues nëpërmjet kablllove LAN.



Qëllimi i sistemi të alarmit është të mbulojë të gjitha mundësitë për hyrje në gjithë ambientet/ zonat me interes.

Impianti do të konfiguruar në 2 nivele mbrojtje:

- Mbrojtje perimetrale për kontrollin e hapjes së dyerve, e cila realizohet me anë të kontakteve magnetike dhe sinjalizon gjendjen e tyre në central;
- Mbrojtje volumetrike e realizuar me sensorë me rreze infra të kuqe, të adresueshëm.

Të gjithë elementet e sistemit do të lidhen nëpërmjet kablllove BUS me centralin e alarmit aktual, me të cilin është bërë kujdes që pajisjet e listuara më poshtë të jenë kompatibël, i cili ndodhet në dhomën teknike, serverin. Do të instalohen kontakte magnetike të cilat lejojnë të kontrollohet statusi i derës gjatë orëve të natës apo kur është jashtë shërbimit dhe do të lajmërojnë nëpërmjet centralit.

10- Sistemi i audio konferencave

Do të parashikohet një sistem për kryerjen e audio-konferencave. Ai do të jetë i pranishëm në 2 hapësira, në katin 0 në auditorin e parashikuar të shkallët dhe në katin 2 në zonën e mbyllur që do të funksionojë si sallë mbledhje. Ky sistem do të ofrojë komunikim me kualitet të lartë audio nga drejtuesi i konferencës dhe në rastin e salles së mbledhjes edhe një sistem për pjesëmarrjen e anëtarëve të mbledhjes.

Ky sistem do të jetë më së shumti i përbërë nga 2 rrjete të pavarur për zonat e parashikuara, që do të instalohen përreth një njesie dixitale qendrore për secilën, dhe një amplifikatori 30W (në varësi të kërkesave për auditorin kjo

ING. DESHIRAMEN
NR. LIC. E061013

mund të ndryshojë) që do të lidhet me bokset me fuqi 6, të montuar mbi sipërfaqen e kolonave me një kabëll audio me seksion 2x0.8mm² të parafabrikuar me gjatësi të ndryshme (5m, 10m ose 15m).



11- Rrjet furnizimi me panele fotovoltaik

Në kuadër të përmirësimit të eficiencës së energjisë, por edhe si një synim për të reduktuar varësinë nga burime jo-të-rinovueshme energjie, është vlerësuar ndërtimi i një sistemi për prodhimin e energjisë elektrike përmes teknologjisë fotovoltaike. Në këtë mënyrë synohet të përmirësohet eficienta energjitike por edhe ulja e barrës mbi rrjetin elektrik publik.



Në dokumentin e specifikimeve teknike trajtohen informacionet dhe të dhënat bazë, si edhe përshkruhen e analizohen në mënyrë të detajuar me vendndodhjen dhe kushtet projektimit. Përcaktimi i vendndodhjes dhe konfigurimi optimal i **impianitit** fotovoltaik bën të mundur të përfitojmë prodhimin optimal të energjisë.

Duke analizuar faktorët si, rrezatimi i favorshëm diellor, gjeografia, sipërfaqja pa hijëzim, orientimi i objektit lidhur me Jugun dhe sipërfaqja e shfrytëzueshme, ofron kushtet optimale për ndërtimin e një impianiti për përftimin e energjisë diellore duke përdorur sistemet fotovoltaike.

Impianiti i energjisë diellore në fjalë është propozuar me fuqi 773 x 455 Wp (fuqi totale në orën e pikut 351.7 kWp) dhe do të instalohet në sipërfaqe të sheshtë, konkretisht soletën e objektit ekzistues të Kryeministrit. Në këtë projekt do të përdoren modulet fotovoltaike për përftimin e energjisë elektrike nga shndërrimi i energjisë diellore. Procesi i gjenerimit të energjisë me anë të paneleve fotovoltaike është një teknologji e pastër, e cila nuk përdor lëndë djegëse fosile, të cilat gjenerojnë gazrat serë që emetohen gjatë procesit. Energjia e gjeneruar do të lidhet në panelin e shpërndarjes së energjisë të objektit në fjalë.



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3






PROJEKTI TEKNIK PËR LEJE NDËRTIMI:
**STRUKTURË EKOLOGJIKE, E GJELBËR, ME KONSTRUKSION DRURI, NË
OBORRIN E BRENDSHËM TË KRYEMINISTRISË**



RAPORT MEKANIK

Grupi i Punës

Projekti Mekanik:

Ing. Aleksandër Konomi – Nr. Lic. M0218/1

Ing. Arkida Zeko – Nr. Lic. M1293

ING. DESHIRAMEN
NR. LIC. E061083

RAPORTI MEKANIK

Instalimet mekanike te Strukturës ekologjike, të gjelbër, me konstruksion druri



Përmbatja:

A: Projekti sanitar

- 1- Furnizimi me ujë për kanalin ujëmbledhës në perimetër të godinës
- 2- Furnizimi me ujë për vaditje
- 3- Sistemi i pompimit
- 4- Shkarkimet e vazove
- 5- Shkarkimet e kanalit perimetral
- 6- Shkarkimet e ujrave të shiut në godinë
- 7- Ulluqet

B: Projekti i sistemit te mbrojtjes kundër zjarrit


- 1- Sistemi MKZ
- 2- Modelet e hidranteve brenda ndertesës si dhe sistemi sprinkler
- 3- Pompat e lëshimit te ujit
- 4- Rrjeti i tubacioneve çelik i zi
- 5- Rezervat per ujë
- 6- Bombulat fikese
- 7- Sistemi i sinjalizimit të zjarrit

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

A: Projekti sanitar

1- Furnizimi me ujë për kanalin ujëmbledhës në perimetër të godinës

Furnizimi me ujë për vaditjen do të realizohet duke shfrytëzuar sasinë e ujit që do të mbushë kanalin perimetral të godinës, i cili do të ketë furnizim nga rrjeti në rast nevojë. Sasia e ujit në këtë kanal do të kontrollohet nga një galexhand elektrik/ mekanik për të ruajtur nivelin e caktuar. Kanali do të jetë i pajisur me një linje tubacioni, e cila do të luaj funksionin e kapërderdhsit në rastet e tej mbushjes me ujë të kanalit nga ujrata e shiut mbi nivelin e caktuar. Uji i kanalit duhet të riqarkullojë nëpërmjet një filtri rëre për të ruajtur pastertinë, me karakteristika 9.0m³/h, pompe çarkullimi Q=16 m³/h, H=20m. Kanali sipas dimensionit plotëson më së miri kërkesat për sasinë e ujit të nevojshëm për vaditje. Realizimi i çarkullimit të ujit kërkon një sistem tubacionesh ku dhënia dhe marrja do të jenë në pozicion të kundërta. Për linjen e furnizimit do të përdoret tub PPR O63.



Per sistemin e furnizimit me ujë të kanalit do të përdoren tuba plastike PPR (Polipropilen) që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 9001 dhe DIN 8078 (kërkesat për cilësinë dhe testimin e tubave). Tubat për furnizimin me ujë duhet të sigurojnë rezistencë ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjenteve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi e transporti, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejtë, jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe rezistence ndaj ujit të ngrohtë.

Vetite e tubave PPR duhet të jenë si më poshtë:

- Densiteti i materialit PPR 0,9 g/cm³
- Pika e ngjitjes 146 gradë celsius
- Konduktiviteti termik në 20 grade 0,23 E/m.K
- Koeficienti i zgjerimit termik linear 1,5 x 0,0001 K
- Moduli i elasticitetit në 20 gradë 670 N/mm²
- Sforcimi gjatë rrjedhjes në 20 gradë 22 N/mm²

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

59

- Sforcimi i thyerjes ne 20 gradë 35 N/mm²

Diametrat e tubave do te jene ne funksion të sasise llogaritëse te ujit për furnizim dhe shpejtësisë së lëvizjes. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret ne intervalet 0,8-1,4 m/sek.

Gjatësia e tubave është 6-12 m, kurse diametri dhe spesori duhet te jenë sipas te dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që l referohen, viti i prodhimit, etj, duhet të jepen të stampuara në çdo tub. Tubat PPR ngjiten me anë të metodës me elektrofuzion duke përdorur pajisjet përkatëse të saldimit me elektrofuzion. Kjo lloj ngjitje garanton nje lidhje te sigurtë, homogjene dhe jetëgjate. Procesi i ngjitjes me elektrofuzion zgjat shumë pak minuta. Gjatë këtij procesi, prerja e tubave, ngrohja e tyre dhe e rakorderive përkatëse PPR bëhet me pajisje të posaçme ngjitjeje. Procesi i ngjitjes me elektrofuzion bëhet si me poshtë:

- 1- Bëhet gati pajisja e saldimit me elektrofuzion dhe veglat e duhura për diametrat e përcaktuara te tubave
- 2- Vihet në prizën e energjisë elektrike pajisja e saldimit dhe kontrollohet llampa e ndezjes, si dhe llampa e punës
- 3- Presim sa të kapet temperatura e saldimit prej 260 gradë celsius
- 4- Shënohet thellësia e saldimit me anë të një lapsi konduktiv.
- 5- Nëse tubat, rakorderitë apo pajisja janë të pista bëhet pastrimi i tyre.
- 6- Fillohet procesi i ngrohjes dhe saldimit të tubave. Koha e ngrohjes, e procesit të saldimit dhe e ftohjes jepen në tabelat përkatëse te mëposhtme të aparatit te saldimit.
- 7- Vendoset fundi i tubit tek vrima e nxehur dhe rakorderia përkatëse ne anen tjetër te pajisjes. Fundet përkatëse të tubit dhe rakorderisë përkatëse, pasi lihen te ngrohen, siç është treguar në tabelë, bashkohen në gjendjen e nxehur që jane dhe lihen të ftohen për pak minuta (shih tabelën). Duhet të kihet parasysh që për diametra të ndryshëm ka kohë të ndryshme për ngrohjen, saldimit dhe ftohjen.

2- Furnizimi me ujë për vaditje



Furnizimi i vaditjes me ujë, për bimësinë e propozuar, është menduar të organizohet nëpërmjet një ndarjeje të caktuar për çdo kat. Cdo grup ka linjën përkatëse dhe është pajisur me valvul automatike. Pikat fundore për çdo dalje do të jenë lehtësisht të regjistrueshme. Linja e tubacioneve për të kryer këtë funksion do të jetë tub plastik polietileni, PEHD100(pn10) Ø20.

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

Valvulat automatike do të futen në punë sipas një programimi të caktuar (duke llogaritur oren e punës si dhe kohën). Programatori jep mundësinë e vaditjes deri katër herë në ditë. Tubat e furnizimit me ujë duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, në ato nyje e pikave të furnizimit për çdo vazo.



3- Sistemi i pompimit

Për të siguruar presionin dhe prurjen e duhur gjatë gjithë ditës në një ndërtesë mund të vendosen, sipas kërkesës së projektit, pompa uji të tipit centrifugale. Pompat duhet të jenë të pajisura me matësin e ujit, matësin e presionit, tubat përkatës të lidhjes së pompës me sistemin e ujësjellesit, panelin elektrik përkatës të tyre, me sistemin e mbrojtjes rele, të mbrojtjes termike, si dhe me sistemin e kontrollit automatik të punës.



Presioni i kërkuar, prurja, fuqia e tyre dhe specifikimet e tjera teknike, duhet të jepen në vizatimet teknike nga projektuesi në funksion të kërkesave ditore për konsum të ujit.

Kur në rrjetin e brendshëm të ujësjellesit ka vetëm pompa, prurja e pompës, duhet të jetë e barabartë me prurjen maksimale ditore të ujit në sekondë. Kur në rrjetin e brendshëm të ujësjellesit ka depozitë uji dhe pompë, prurja e pompës duhet të përgjigjet grafikut ditor të përdorimit dhe dërgimit të ujit nëpër ndërtesë. Në percaktimin e lartësive të ngritjes së pompës (presioni i kërkuar) duhet të merret në konsideratë lartësia e ndërtesës, presioni i ujit në rrjetin e jashtëm të ujësjellesit si dhe humbjet lokale nëpër kthesat, daljet, në çdo pjesë të ndërtesës.

Fuqia e pompës së ujit percaktohet me anë të formulës perkatëse si me poshtë:

$$N = Q \times H / 102 \times n$$

Ku: Q = prurja e ujit që duhet të pompohet në l/sek

H = Lartësia e dërgimit të ujit

n = rendimenti i pompës i cili duhet të jete me teper se 65 % dhe jepet nga prodhuesi i pompes.

Kapacitet e pompave sipas objekteve:

Pompat e ujit të cilat do të shërbejnë për furnizimin e sistemit do të instalohen në katin -01, aty ku për momentin është ambjenti teknik i godinës ekzistuese.

Janë parashikuar të instalohen dy pompa, ku njëra do të mbetet rezervë.

Karakteristikat e secilës do të jenë;

Q=5.0 m³/h

H=50.0 m

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/3

61



4- Shkarkimet e vazove

Pikat e shkarkimit të vazove do të mblidhen në disa grupime, si në projekt. Për shkarkimet e vazove do të përdoren tubacione tuba HTPP25-32.



Për shkarkimet e ujrave do të përdoren tuba plastike HTPP që plotësojnë të gjitha kërkesat e cilësisë sipas standartit ISO 4427 dhe prEN 12201.



Këto tuba duhet të sigurojnë rezistencë perfekte ndaj korrozionit, rezistencë të lartë ndaj agjenteve kimike, peshë të lehtë, mundësi të thjeshta riparimi, transporti dhe lidhje, ngjitje të thjeshtë dhe të shpejta. Permasat e tubave do të jenë në funksion të sasisë llogaritëse të ujit të ndotur, shpejtesisë së lëvizjes dhe shkallës së mbushjes së tyre. Gjatë llogaritjeve, shpejtësia e lëvizjes duhet të merret 1-2 m/sek kurse shkalla e mbushjes duhet të jetë 0,5 - 0,8 e seksionit të tubit. Gjatësia e tubave duhet të jete 6-10 m kurse diametri dhe spesori duhet të jenë sipas të dhënave në vizatimet teknike. Të dhënat mbi diametrin e jashtëm të tubit, presionin, emrin e prodhuesit, standartit që i referohen, viti i prodhimit, etj duhet të jepen të stampuara në çdo tub. Tubat e shkarkimit duhet të vendosen në të gjithë lartësinë e ndërtesës, në formën e kollonave, të përcaktuar sipas shafteve dhe të degëzuar në grupime të ndryshme vazosh.

Të gjitha punet e lidhura me instalimin dhe vendosjen e tyre në objekt duhet të behen sipas kërkesave teknike të supervisorit dhe të projektit. Bashkimet e tubave të shkarkimit duhet të behen me mastik të pershtatshëm për tuba HTPP i rekomanduar nga prodhuesi i tubave. Depozitimi i ujrave do të kalojë në kanalim perimetral të godinës.

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

5- Shkarkimet e kanalit perimetral

Linja e shkarkimit të kanalit perimetral do të bëhet me tuba PVC110 SN8. Ku depozitimi fundor do të lidhet me pusetat ekzistuese të ujrave të bardha. Kjo për të evituar tejmbushjen e kanalit. Standartet e këtyre tubave do të jenë sipas EN 13476 standard ose kompakt sipas EN 1401 standard.

Standartet:

PNS 1950:2003 - Sistemet e tubacioneve plastike për shkarkimin e mbetjeve (për temperature të ulët dhe të lartë) brenda ndërtesave. Polivinil klorur i paplastifikuar (PVC-U). ISO 4435: 1991 - Tuba dhe pajisje të paplastifikuara poli (klorur vinil) (PVC-U) për kullimin e groposur dhe sistemet e kanalizimeve. ASTM D 1784 – Specifikime për materialin



Karakteristikat

- Peshë e lehtë dhe e lehtë në përdorim dhe instalim
- Rezistent ndaj korrozionit
- Rezistent ndaj goditjeve të papritura dhe ngarkesave të jashtme
- Rezistent ndaj kimikateve dhe substancave
- Fiksion i shpejtë dhe i lehtë në pusetat
- Te riciklueshme
- Jetëgjatësi mund të shërbejë deri në 50 vjet

Përdorimi

- Shkarkime nëntokësore
- Shkarkimet e ujrave

Informacione teknike

- Ngjyra: portokalli/ kafe
- Gjatësia: 3, 4, 5 +- 10 mm
- Lihjet: me gomina dhe rakoderi
- Diametri: 110 – 800 mm



ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E061013

63

6- Shkarkimet e ujrave te shiut ne godine

Një pikë e rëndësishme gjatë projektimit të një ndërtimi është edhe kullimi i ujrave të shiut, që grumbullohen nëpër godinë, kjo për efekt të strukturës arkitektonike. Ujrat e shiut ose duhet të vendosen në kanalizimin ekzistues të zonës ose preferohet që të grumbullohen dhe të shfrytëzohen. Me ujë grumbulluar mundet të ujitet pejsazhi ose ai të plotesoje ndonjë detyrë tjetër. Cative, ballkoneve, taracave dhe elementeve të tjera të ndërtimit, duhet tu hiqet uji me një sistem të përbërë prej ulluqeve dhe tubave. Në rast se uji i shiut nuk e demton pejsazhin dhe truallin, atëherë ai mundet edhe të mos lidhet me kanalizimin ekzistues por të vendoset në atë mënyrë që ai të mund të filtrojë në dyshemene me pllaka metalike dhe më pas të rrjedhë në pjesën anësore të saj nëpërmjet daljeve. Kjo sasi uji do të mbledhet në kanal in perimetral të godines.

Për ujrat e shiut do të përdoren tubacione plastik me gomine HTPP110 (EN1451). Kalimet e tyre do të jenë neper shaftet e përcaktuar në projekt.

(shënim: mund ti referohemi dhe tubacioneve PVC 110/50 sipas specifikimeve teknike me sipër)

Keto tubacione kombinuar në instalim me piletat mund të bëjnë të mundur dhe shkarkimet e ujave të shiut në godinë, përveç shkarkimit nëpërmjet dyshemese kulluesë.



7- Ulluqet

Për kullimin e elementeve ndërtimore nevojitet një sistem i përbërë prej tubave dhe ulluqeve. Materiali prej të cilave janë të prodhuara keto element të sistemit duhet të jenë rezistent ndaj agresivitetit të ujit të shiut dhe kundër ndikimeve tjera si psh gjendjeve ekstreme të motit etj. Tubat duhet të jenë të hermetizuara dhe të durojnë një shtypje të pakten 0.5 bar pa ndonjë demtim. Për të plotësuar këto kërkesë duhet saldimit i tubave të bëhet në mënyrë perfekte dhe të kontrollohet nga arkitekti. Tubat prej llamarine për kullimin e ujrave të shiut lejohen të përdoren vetëm jashtë ndërtimit. Në rast se tubat duhet të vendosen brenda ndërtësës, atëherë ata duhet të jenë plastike ose ndonjë material tjetër.

Ulluqet si elemente të sistemit mund të jenë prej materiali të ndryshëm, por duhet të jenë prej materialit të njëjtit, si tubat me të cilat ata do të lidhen. Forma e tyre mundet të jete gjysem rrethi ose ndonjë formë tjetër, si psh katrore.

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E0610/3

B: Projekti i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit

1- Sistemi MKZ

Sistemi MKZ do të karakterizohet nga këto tipe sistemesh:

Tipe të fiksuara

- Hidrante brenda ndërteses

Tipe portabël

- Bombula të ndryshme



2- Modelet e hidranteve brenda ndërteses si dhe sistemi sprinkler

Hidrانتet që gjenden brenda nje ndërtese duhet të jenë të tipit të përshkruar dhe paraqitur me poshtë ose të ngjajshme. Një hidrant përbehet prej saraçineskes (hidrante), tubit, linit dhe kutisë në të cilën ata janë vendosura. Tubat e hidrante janë të shumëllojshme sipas nevojës dhe prodhuesit. Ata kanë si zakonisht nje gjatësi prej maksimal 30 m. Për raste të veçanta duhet kontaktuar prodhuesi i hidranteve dhe te gjendet nje zgjidhje e veçante. Kutia e hidrantit mundet të fiksohet në mure, por rekomandohet që ajo te futet ne mure brenda ne ate menyre, që kapaku i kutise te kete nje nivel me murin. Ky sistem i vendosjes eshte me i sigurt, sidomos kur bëhet fjalë për ndertime publike, spitale, shkolla etj. Në kutinë e hidrantit mund të integrohet edhe nje bombule fikese kunder zjarrit, siç eshte e paraqitur në fotografitë e mëposhtme.



Tipi	Modeli	Dimensionet e kutise
		(mm)
7004B	ES-ST	600x700x140
7014B	ES-ST-FL	950x880x220
7114B	ES-ST-FL-FM	950x880x220
7154B	ES-ST-FLU-FM	600x1100x220
7004C	WS-ST	640x740x140
7014C	WS-ST-FL	990x920x220
7114C	WS-ST-FL-FM	990x920x220
7154C	WS-ST-FLU-FM	640x1140x220

ING. DESHIRAMENA
NR. LIC. E 0610/13

3- Pompat e lëshimit të ujit



Në raste zjarri zjarrfikësit duhet të kenë furnizimin e plotë me ujë të posaçëm për ta luftuar zjarrin. Kjo arrihet duke vendosur hidrante brenda. Hidrantet duhet të kenë një sasi uji me një shtypje (presion), të mjaftueshëm. Në rast të mungesës së ujit nga rrjeti komunal apo të mungesës së presionit të tij, duhet të projektohen pompa të cilat e garantojnë presionin e nevojshëm për të luftuar zjarrin nga zjarrfikësit. Po ashtu duhet patur parasysh, në raste të mungesës së ujit, të gjenden burime të tjera të ujit me një sasi të mjaftueshme. Këto kërkesa duhen plotësuar sipas normave / standardeve moderne. Po ashtu duhet gjatë projektimit të ndërtesës të kontaktohen autoritetet e zjarrfikësve për të plotësuar kërkesat e atyre për një ndërhyrje të sukseshme në raste zjarri. Pompa e projektuar për të mbuluar sistemin e antizjarrit do të jetë grup pompe për çdo objekt, me këto karakteristika:
OBJEKTI POMPA E SISTEMIT TE HIDRANTEVE: Q=21m³/h, H=50 m



4- Rrjeti i tubacioneve çelik i zi



Sistemi i tubacioneve për furnizimin me ujë të hidranteve do të jetë prej çeliku të galvanizuar, të lypër me bojë antiruxho kundër korozionit, përfshirë dhe rakorderite. Sigurimi i ujit për antizjarrin do të realizohet në dhomen teknike ekzistuese të objektit.

5- Rezervat për ujë

